

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORE E KOMBINIMIT - DIRECTION DE L'AMENAGEMENT
Nr.faq/No.štr. 111
Datë/Datum: 14.07.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



RREGULLORE

PËR

TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME

QERSHOR 2017

Bazuar në nenin 4, të Ligjit Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare Nr. 88/2010), nenin 2 të Ligjit Nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204, nenin 12, paragrafi 12.1 shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 9 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2017, pa ndryshime aprovon:

RREGULLOREN PËR CAKTIMIN E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN 2018

Neni 1

1. Duke u bazuar në nenin 6, të Ligjit Nr. 03/L-204, 'Për tatimin në pronën e Paluajtshme', baza tatimore për Komunën e Fushë Kosovës do të caktohet si më poshtë sipas zonave të vlerës së tregut në m²:

1.1 Zona e parë

Lloji i pronës	Vlera për m ²
Pronat Residenciale (Banesë - Apartman)	450
Pronat Residenciale - Shtëpi	290
Pronat Komeriale	650
Pronat Industriale	150
Pronat Bujqësore	100
Pronat e pameremetuara	116
Garazhat/parking	100
Pronat e braktisura	100
Pishinat	150
Fusha sportive të pambuluara	80
Fushat sportive të mbuluara	120

1.2 Zona e dytë

Lloji i pronës	Vlera për m ²
Pronat Residenciale (Banesë - Apartman)	420
Pronat Residenciale - Shtëpi	250
Pronat Komeriale	600
Pronat Industriale	150
Pronat Bujqësore	100
Pronat e pameremetuara	100
Garazhat/parking	80
Pronat e braktisura	80
Pishinat	140
Fusha sportive të pambuluara	70
Fushat sportive të mbuluara	100

1.3 Zona e tretë

Lloji i pronës	Vlera për m ²
Pronat Residenciale (Banesë - Apartman)	390
Pronat Residenciale - Shtëpi	220
Pronat Komerciale	550
Pronat Industriale	150
Pronat Bujqësore	100
Pronat e pameremetuara	88
Garazhat/parking	60
Pronat e braktisura	60
Pishinat	130
Fusha sportive të pambuluara	60
Fushat sportive të mbuluara	80

1.4 Zona e katërt

Lloji i pronës	Vlera për m ²
Pronat Residenciale (Banesë - Apartman)	
Pronat Residenciale - Shtëpi	200
Pronat Komerciale	450
Pronat Industriale	150
Pronat Bujqësore	100
Pronat e pameremetuara	80
Garazhat/parking	60
Pronat e braktisura	60
Pishinat	120
Fushat sportive të pambuluara	40
Fushat sportive të mbuluara	60

Neni 2

Duke u bazuar në vendndodhjen e pasurisë, e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj, në Komunën e Fushë-Kosovës janë përcaktuar 4 zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Neni 3

- Zona e parë** - Përfshin të gjitha objektet që kanë dalje në rrugën kryesore „Nënë Tereza” - Sheshi “Dëshmorët e Lirisë” dhe “Rruga e Pejës” nga udhëkryqi deri në hekurudhën Fushë-Kosovë-Ferizaj (Ura e Madhe).
- Zona e dytë** - Përfshin të gjitha objektet që nuk përfshihen në zonën e parë deri në 200 m në të dy anët e rrugës “Nënë Tereza” dhe “Rruga e Pejës” dhe të gjitha objektet që kanë dalje në magjistralen Prishtinë/Pejë prej urës së hekurudhës deri në kufi me Drenasin (Krivovë). Të gjitha objektet industriale dhe komerciale që janë të lidhura me binarë hekurudhor industrial përfshihen në zonën e dytë, pa marrë parasysh zonën që i përkasin.

3. **Zona e tretë** - Përfshin objektet jashtë zonës së dytë Nakaradë, pjesa e Fushë-Kosovës përtej hekurudhës deri në kufi me fshatin Lismir
4. **Zona e katërt** - Përfshin këto fshatra: Vragoli, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Bardh i Vogël, Bardh i Madh, Pomozotin, Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, Henc, Harilaç, Lismir, Kuzmin, Graboc i Poshtëm.

Neni 4

Në pajtim me nenin 2, të Ligjit Nr. 04/L-100, për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204 normat tatimore për vitin tatimor 2017 për Komunën e Fushë-Kosovës do të jenë si vijon:

Përshkrimi	Norma
Pronat Residenciale (Banesë - apartman)	0.15%
Pronat Residenciale - Shtëpi	0.15%
Pronat Komerciale	0.22%
Pronat Industriale	0.15%
Pronat Bujqësore	0.15%
Pronat e pameremetuara	0.15%
Garazhat/parking	0.15%
Pronat e braktisura	0.15%

Neni 5

Normat e kualitetit për vlerësimin e objekteve bazohen në Udhëzimin Administrativ 03/2011, për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin.

Neni 6

- 1 Pronat e gatshme për shfrytëzim:
 - 1.1 Për banim - këto prona konsiderohen si të gatshme në qoftë se kanë: dyer, dritare, janë të suvatuara, kanë të shtruar dyshemenë, të instaluar rrymën, ujin, kanalizimin (nëse ekziston rrjeti, nëse jo merret edhe pa këto elemente si e gatshme, pa llogaritur kyçjen në rrjetin primar).
 - 1.2 Pronat komerciale - këto prona konsiderohen si të gatshme nëse: kanë dyer dhe dritare, janë të suvatuara, kanë të shtruar dyshemenë dhe të instaluar rrjetin elektrik. Për depo, merret si e gatshme, (varësisht nga lloji i mallit) edhe nëse ka vetëm dyer dhe dritare, ka të instaluar rrymën dhe nëse dyshemeja është e shtruar me beton.
 - 1.3 Prona të papërfunduara hyjnë objektet që kanë të përfunduar ndërtimin e vrazhdë
 - 1.4 Prona të braktisura - konsiderohen objektet e vjetruara, të cilat nuk i plotësojnë kushtet për kurrfarë aktiviteti.

Neni 7

Pronat të cilat lirohen nga Tatimi në Pronë, janë të cekura në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Neni 8

Në pajtim me nenin 4, të Ligjit Nr. 04/L-100 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Palujtshme Nr. 03/L-204 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2011, neni 1, Kryetari i Komunës emëron Bordin e Pavarur për shqyrtimin e Ankesave administrative të tatimpaguesve.

Neni 9

Ligji Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Palujtshme në Kosovë dhe Udhëzimet Administrative, rregullojnë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 10

Kjo Rregullore e pandryshuar hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Rr-Nr. 111 2017

Datë 29.06.2017

Kuvendi i Komunës Fushë-Kosovë

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi

